FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

EUGENOL

Preparat dentar
Tretësirë me pika për përdorim lokal – 100 %
(Eugenol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Eugenol dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Eugenol
3. Si ta përdorni Eugenol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Eugenol
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË EUGENOL DHE PËRSE PËRDORET

Eugenoli ka veprim analgjezik dhe antiseptik dhe prodhon anestezi lokale. Veprimi bakteriostatik i eugenolit është kundër: *Staphylococcus aureus, Escherichia coli, Pseudomonas aeruginosa* dhe *Candida albicans*.
Përdoret në stomatologji, shpesh i përzier me oksid zinku. Është irritues.
Përdoret si bar për qetësimin e dhimbjeve të dhëmbit (një pambuk i lyer vendoset brenda kavitetit të dhëmbit të prishur) në mbushjet e përkohshme dentare me oksidin e zinkut dhe si përbërës në preparatet e higjienës orale.
Ai mund të përdoret dhe si aromatizues. Esenca e karafilit ka veti antihelmintike.
Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Eugenol për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë Eugenol.

2. PËRPARA SE TË PËRDORNI EUGENOL

Mos përdorni Eugenol në qoftë se jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj kësaj lënde sepse mund të shfaqen reaksione alergjike, përfshi edhe anafilaksinë.

Tregoni kujdes të veçantë me Eugenol
Gjatë përdorimit të eugenolit në kavitetin e dhëmbit të prishur duhet të mbahet parasysh që të mos aplikohet disa herë në të njëjtin vend sepse mund të dëmtojë indet xhinxhivale.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Eugenol.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Eugenol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Ndërveprimet medikamentoze klinikisht të rëndësishme vërehen pas përthithjes sistemike të eugenolit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- lidokainë, si një qetësues tjetër dhimbjesh: në këtë rast ndodh rritja e efektit të lidokainës nga eugenoli;
- aspirinë, antikoagulantë (varfarinë ose heparinë), antiinflamatorë (ibuprofen ose naproksen): me eugenol rrisin riskun e gjakosjes së mukozave;
- antidiabetikë dhe insulinë: eugenoli ul nivelin e sheqerit në gjak; në rast kur është i nevojshëm përdorimi i eugenolit nga këta pacientë, ata duhet të monitorohen;
- antimykotikë, antihistaminikë, antineoplastikë: eugenoli mund të veprojë me to.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të përdorni këtë bar.
Siguria e përdorimit të këtij bari në shtatzëni dhe gjatë ushqyerjes me gji nuk është vërtetuar ende, megjithatë duhet të evitohet përdorimi si gjatë shtatzënisë, ashtu edhe gjatë ushqyerjes me gji.
Kategoria C.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Duhet patur kujdes gjatë ditëve të kurimit me Eugenol sepse ai mund të japë efekte anësore të tilla si: sedacion, çrregullime në frymëmarrje, marramendje. Evitoni përdorimin e automjeteve dhe makinerive.

3. SI TA PËRDORNI EUGENOL

Gjithmonë përdoreni Eugenol sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj. Në qoftë se ndjeni që efektet e Eugenol janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Dozimi:

- Dentisti juaj do t'ju informojë për dozën e Eugenolit që duhet të përdorni dhe kur ta përdorni atë. Është e rëndësishme që të ndiqni udhëzimet e dentistit tuaj me përpikmëri dhe të mos e ndryshoni asnjëherë vetë dozen, sido që të ndiheni.
- Pyeteni dentistin apo farmacistin tuaj në qoftë se jeni i pasigurt për dozën që duhet të përdorni dhe kohën e përdorimit.

Sipas porosisë së dentistit, vendoset një tampon pambuku i lyer me eugenol në kavitetin e dhëmbit të prishur.
Pikat mund të shkaktojnë ndjesi djegieje, por kjo ndjenjë nuk zgjat më shumë se disa minuta. Në të kundërt, konsultohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Në qoftë se keni përdorur më shumë Eugenol
Në qoftë se keni përdorur më shumë Eugenol se sasia që duhet, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.
Mbidozimi është i mundur dhe efektet anësore që mund të ndodhin si pasojë e mbidozimit prej eugenolit përfshijnë simptoma si: konvulsione, diarre, të përziera, marramendje, rrahje të shpeshta të zemrës, skuqje të urinës së pacientit.

Në qoftë se harroni të përdorni Eugenol
Në qoftë se harroni një dozë Eugenol, përdoreni atë sa më shpejt. Në qoftë se është pothuajse koha për dozën tjetër, kalojeni dozën e humbur.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Eugenol mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Efektet anësore më të zakonshme të eugenolit janë: reaksione alergjike, kruarje, të vjella, vështirësi në frymëmarrje, sedacion, djegie, dëmtim lokal i indeve të gojës, dëmtim i palcës së dhëmbit, humbje lokale e ndjeshmërisë, risk i lartë i dëmtimit të kavitetit të gojës, plagë në buzë.
Kur shfaqet ndonjë nga efektet anësore të mësipërme, mjekimi me Eugenol duhet ndërprerë dhe ju duhet të këshilloheni me mjekun ose me farmacistin.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI EUGENOL

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Eugenol pas datës së skadencës të shënuar në paketim.
Ruajeni në temperaturën 10°C - 25°C!
Mos e ruani në ngrirje!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe nga lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Eugenol
Lënda vepruese është eugenol i bidistiluar.
Çdo shishe plastike përmban 5 ml eugenol 100%.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me një shishe plastike.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.
Përmbajtja. Kujdes. Tretësirë me pika.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.Fax: 00 355 4 23 62 800
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2013.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.